

Bazuar në nenin 36 paragrafi 1, nën paragrafi 1.17 dhe nenit 65 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenet 7, 35, 37, 85, 97, 99 dhe 114 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare si dhe nenet 3.3 dhe 52 të Rregullores nr.2001/25 për Licencimin, Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Kompanive të Sigurimeve dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimeve, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2015, lëshoi këtë:

**UDHËZIM Nr. 01/2015**  
**për Verifikimin e të Kaluarës Penale për Aksionarët Kryesorë, Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Institucioneve Financiare**

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi është të përcaktojë procedurën dhe dokumentacionin që kërkohet nga BQK-ja gjatë procesit të shqyrtimit dhe verifikimit të kërkesave për aprovimin sa i përket të kaluarës penale të aksionareve kryesorë, drejtorëve, menaxherëve të lartë dhe personave të tjerë, për të cilët sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, kërkohet aprovim nga BQK-ja .
2. Ky Udhëzim zbatohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjatë trajtimit dhe verifikimit të kërkesave sipas paragrafit 1 i këtij neni.

**Neni 2**  
**Verifikimi i të kaluarës penale**

1. E kaluara penale është një ndër kriteret themelore për t'u aprovuar një individ si aksionar kryesor, drejtor, menaxher i lartë apo çdo pozitë tjetër në institucione financiare për të cilin sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi kërkohet aprovim nga BQK-ja.
2. Për çdo kërkesë lidhur me personat për të cilët kërkohet aprovim nga BQK-ja, institucionet financiare duhet t'i bashkëngjitin edhe dëshmitë zyrtare nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale, që mund të jetë duke u zhvilluar ndaj personit të propozuar.
3. Sigurimi i dokumentacionit nga paragrafi 2 i këtij neni është përgjegjësi e institucionit financiar që ka bërë kërkesën për aprovim të individit të caktuar.

4. Vlerësimi i kërkesave për aprovim bëhet në pajtim me ligjet, instrumentet rregullatore të BQK-së, si dhe manualët e licencimit të aprovuara nga BQK-ja.

### **Neni 3**

#### **E drejta për informacione shtesë**

1. Sipas vlerësimit të saj, BQK-ja mund të kërkojë informacione edhe nga institucionet tjera kompetente sipas legjislacionit në fuqi, sa i përket personave të propozuar për aprovim, të cilat mund ta bëjnë personin e propozuar të padenjë për ta ushtruar detyrën në të cilën është propozuar për aprovim.
2. Nëse informatat sipas paragrafit 1 të këtij neni, konfirmohen nga institucionet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, atëherë BQK-ja mund ta refuzojë aprovimin e personave të tillë.

### **Neni 4**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.

  
Bedri Hamza

Kryesues i Bordit Ekzekutiv